



REPublika e Kosovës
REPublika Kosovo - Republic of Kosovo
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OF OBILIC



Datë/Data/Date:	22.12.2025
Nga/Od/From:	z. Halil Thaçi – Kryetar i Komunës së Obiliqit
Për/Za/To:	z. Sami Ahmeti – Kryesues i Kuvendit Komunal të Obiliqit
Tema/Subjekat/Subject	Kërkesë për Seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal

I nderuar kryesues i Kuvendit Komunal z. Sami Ahmeti,

Ju drejtohem me kërkesë, në cilësinë tuaj si kryesues i Kuvendit të Komunës së Obiliqit, që të thirrni seancë të jashtëzakonshme, me qëllim të sigurimit të funksionimit sa më efikas të Kuvendit Komunal dhe respektimit të afateve për formimin e organeve të tij, në të cilën do të shqyrtohen dhe miratohen edhe pikat e mëposhtme:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-Vendimit për miratimin paraprak të Listës së Përgjithshme dhe Listës së Veçantë të Pronave të Paluejtshme të Komunës
2. Formimi i Komitetit për Politikë dhe Financa
3. Formimi i Komitetit për Komunitete
4. Formimi i Komisionit Komunal të Aksionareve të N.P.L. "Kastrioti" SH.A.

Me respekt!